



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË


RAPORT STATISTIKOR VJETOR

2019

I. STATISTIKË E PROCESIT

I. 1 - Vendime të njoftuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në referencë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2019, është njoftuar për 127 vendime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me një shpërndarje në muaj, sikurse tregohet në grafikun nr. 1.




Grafiku nr. 1 - Numri i vendimeve të ardhura në IKP sipas muajve

127 vendimet e ardhura përmbajnë këta dispozitivë:


- 54 konfirmime;**
- 44 shkarkime;**
- 28 të deklarojë se procesi është ndërprerë;**
- 1 pezullim.**

Në grafikun nr. 2 paraqitet në mënyrë më të përmbledhur dispozitivi i vendimeve të ardhura nga KPK-ja.




Grafiku nr. 2 - Dispozitivi i vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK, sipas muajve

Në grafikun nr. 3 pasqyrohet ecuria e vendimeve të njoftuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe i dispozitivit të tyre, në vitet 2018 dhe 2019.




Grafiku nr. 3 - Pasqyrë përmbledhëse e vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK dhe e dispozitivit të tyre

Subjektet e rivlerësimit, 127 subjekte, për të cilat janë njoftuar vendimet nga KPK-ja, janë të funksioneve të ndryshme.



Grafiku nr. 4 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve - viti 2019


Krahasuar me vitin 2018, rezulton kjo ecuri:



Grafiku nr. 5 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, viti 2018 - 2019


I. 2 - Rekomandime të ardhura nga ONM-ja

Në referencë të pikës 2, të nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për vitin 2019, në Institutin e Komisionerëve Publikë kanë ardhur dhe janë administruar 5 rekomandime nga ONM-ja. Në grafikun e mëposhtëm tregohet perioda e ardhjes së tyre.



Grafiku nr. 6 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas muajve


Krahasuar me vitin 2018 rezulton kjo ecuri:



Grafiku nr. 7 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, në vitet 2018 - 2019


I. 3 - Shqyrtimi i vendimeve nga Komisionerët Publikë

Gjatë vitit 2019, pas shqyrtimit të vendimeve të njoftuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 13 vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për 114 vendime është njoftuar mosankim.




Grafiku nr. 8 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, rezulton kjo ecuri:




Grafiku nr. 9 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë vitet 2018 - 2019

Në të dy grafikët e mëposhtëm paraqitet vendimmarrja e Komisionerëve Publikë në këndvështrim të statusit të subjekteve të rivlerësimit dhe të periudhës së marrjes së tyre.



Grafiku nr. 10 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas statusit të subjekteve të rivlerësimit




Grafiku nr. 11 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas muajve

II. PJESËMARRJA NË SEANCAT E GJYKIMIT TË ANKIMIT TË IKP-SË NË KPA

Shqyrtimi gjyqësor i ankimeve të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nga Komisioneri Publik, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në seanca publike.


Krahasuar me vitin 2018, rezulton kjo ecuri:



Grafiku nr. 12 - Numri i seancave dhe i subjekteve të rivlerësimit në total për vitet 2018 - 2019


III. DENONCIMET NGA PUBLIKU

Në referencë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në faqen zyrtare të Institucionit të Komisionerëve Publikë është publikuar formulari i denoncimit dhe kontaktet e Specialistit të Pritjes me Popullin. Në Regjistrin e Denoncimeve të Publikut, për periudhën janar - dhjetor 2019, nga të tri mënyrat e njoftimit janë regjistruar **361 denoncime**.




Grafiku nr. 13 - Numri i denoncimeve nga publiku sipas mënyrës së njoftimit

Analizuar sipas periudhës kohore të ardhura në IKP, denoncimet nga publiku paraqesin këtë grafik:




Grafiku nr. 14 - Shpërndarja e denoncimeve nga publiku sipas muajve, viti 2019

Referuar fazës së procesit të rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, nga të tri institucionet e rivlerësimit, rezulton kjo pasqyrë:




Grafiku nr. 15 - Numri i denoncimeve sipas fazës së vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, viti 2019

Grafiku i mëposhtëm tregon statusin e subjekteve të rivlerësimit të denoncuar nga publiku.



Grafiku nr. 16 - Numri i denoncimeve sipas fazës së vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, viti 2019


Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, rezulton kjo ecuri:



Grafiku nr. 17 - Ecuria e denoncimeve nga publiku në IKP për vitet 2018 - 2019

IV. TRAJTIMI I KËRKESAVE PËR INFORMACION NGA PUBLIKU

Sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014, në Institucionin e Komisionerëve Publikë, nën përgjegjësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, trajtohen kërkesat për informacion nga publiku, duke administruar Regjistrin e Kërkesave dhe të Përgjigjeve, i cili publikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe përditësohet çdo tre muaj.




Grafiku nr. 18 - Ecuria e kërkesave për informacion të trajtuara në IKP, sipas viteve 2018 - 2019

V. SITUATA BUXHETORE PËR VITIN 2019, PËR INSTITUCIONIN E KOMISIONERËVE PUBLIKË,

paraqitet në tabelën në vijim.

Në mijë lekë


Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	65,830	72,762	68,163	93.7%
Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,356	90.4%
TOTALI	67,330	74,262	69,519	93.6%



Grafiku 19 – Realizimi i buxhetit për vitin 2019

Çdo shpenzim për furnizimin materialo-technik të stafit të institucionit dhe administrimin e institucionit është kryer konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2019 dhe në përputhje me dispozitat ligjore.


Mund të themi që janë finalizuar me sukses dhe në afatet e përcaktuara kohore pothuajse të gjitha procedurat e prokurimit të planifikuara, ndër të cilat 13 procedura prokurimi të blerjeve me vlerë të vogël dhe rreth 20 procedura për blerje mallrash dhe shërbimesh, me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSH, me procedura të thjeshtuara, sipas përcaktimeve ligjore, duke plotësuar kështu nevojat dhe kërkesat e argumentuara të punonjësve, për krijimin e kushteve optimale të punës për të gjithë stafin e institucionit dhe mbështetjen e veprimtarisë institucionale.



Grafiku 20 - Ecuria e procedurave të prokurimit, të zhvilluara në vitin 2019

Në mënyrë analitike, realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2019, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim në formë tabelare dhe grafike

Investimet	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në%
Blerje pajisje elektronike	850	850	838	99%
Blerje pajisje dhe mobilie zyre	650	650	518	80%
TOTALI	1,500	1,500	1,356	90.4%



Grafiku 21 - Realizimi i investimeve 2019 sipas projekteve (në mijë lekë)